

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E MBROJTJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

|                                    |                          |
|------------------------------------|--------------------------|
| <b>Nr<sup>1</sup> i prokurimit</b> | <b>217-25-5993-1-1-1</b> |
| <b>Nr i brendshëm</b>              | <b>21700/25/023/111</b>  |

Sa i përket tenderit për: **“Ritender - Furnizim me jelek taktik - SUFSK 1001 për nevojat e FSK-së”**.

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**Smart X Industries SH.P.K.**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Fehmi Agani , H 69/D-2**

(Adresa)

**Prishtinë**

(Vendi)

**10000**

(Kodi postar)

**+38344311070**

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

**Adriatik Rrustemi**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

**smartxindustries@gmail.com**

(Adresa elektronike)

**22.08.2025**

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë me dt. 03.07.2025  
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave me dt. 29.08.2025  
Kërkesa për informacione shtesë: 23.07.2025  
Kërkesa për rishqyrtim e dt. 12.08.2025  
Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt: 14.08.2024

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☐

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☐

Jo

☐

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së  
Neni 7 i LPP-së  
Neni 27 i LPP-së  
Neni 69 i LPP-së  
Neni 17.7 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik  
Neni 25 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik  
Neni 37 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.

**\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.**

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me dt. 03.07.2025 është publikuar tenderi me “Ritender - Furnizim me jelek taktik - SUFSK 1001 për nevojat e FSK-së”.

Ne si palë e interesuar për të ofertuar në këtë projekt, e kemi analizuar dosjen e tenderit në tërësi dhe njoftimin për kontratë, ndërsa kemi vërejtur se janë vendosur disa kërkesa të paqarta dhe diskriminuese tek specifikimet teknike, të cilat do të sqarojmë më poshtë:

Fillimisht ju sqarojmë se ne me dt.23.07.2025 kemi parashtruar kërkesë për informacione shtesë, ndërsa me dt.01.08.2025, autoriteti kontraktues ka publikuar përgjigjet në lidhje me pyetjet e parashtruara nga ne. Pasi që i kemi analizuar përgjigjet e AK-së, ne i kemi analizuar edhe një herë edhe specifikimet teknike ku e kemi vërejtur që specifikimet teknike nuk janë hartuar në mënyrë të rregullt nga ana e njësisë kërkuese apo AK-së, prandaj jemi të detyruar të parashtrojmë këtë kërkesë për rishqyrtim.

1. Tek pyetja e dytë e jona ku kemi kërkuar që të lejohet një tolerancë prej  $\pm 2\text{cm}$  për të gjithë xhepat, AK-ja e ka cekur se toleranca prej  $\pm 2\text{cm}$  është e përfshirë në specifika teknike për jelekun. Në lidhje me këtë përgjigje të AK-së, ne si kompani e kemi të paqartë se a është lejuar apo jo të prezantohen të gjithë xhepat me një tolerancë prej  $\pm 2\text{cm}$  apo jo? Nëse eventualisht ju si autoritet kontraktues nuk e keni lejuar një tolerancë të tillë prej  $\pm 2\text{cm}$ , për të gjithë xhepat, atëherë ne si kompani edhe një herë kërkojmë që të lejohet një tolerancë prej  $\pm 2\text{cm}$ , me qëllim të hapjes së konkurrencës, pasi që një tolerancë e tillë nuk ndikon aspak në funksionin e këtij produkti.

-Njëkohësisht kërkojmë që të na sqarohet se si do të bëhet matja e gjatësisë së xhepave, pasi që në këtë rast po krijohen konfuzione në lidhje me madhësitë e xhepave.

Më poshtë po ju japim një ilustrim me fotografi me qëllim që të informohemi se si do të bëhet matja e gjatësisë së xhepit:



Pra kërkojmë që të qartësohet se a do të bëhet matja sipas fotografisë A+C (xhepi së bashku me kapakun), apo centimetrat e xhepave do të maten vetëm xhepi pa kapak d.m.th. vetëm shkronja A sipas fotografisë së vendosur më lartë?

Kjo gjë duhet të qartësohet sepse në këtë rast kompanitë ofertuese mund të eliminohen nga aktiviteti i prokurimit pas ofertimit, për specifika të cilat nuk janë të qartësuara në detaje.

2. Në lidhje me pyetjen tonë sa i përket metodave të testimit, autoriteti kontraktues në përgjigjen e saj e ka cekur se metodat e kërkuara nga OE ISO 1421 dhe ISO 4674, janë metoda të cilat nuk ofrojnë vlerësim adekuat për jelek taktik.

Ne kemi bërë analizimin e përgjigjes së AK-së dhe kemi ardh në përfundim që kërkesa jonë që të lejohen këto standarde të testimit ISO 1421 dhe ISO 4674, në vend të ISO 13934 dhe ISO 13937, është kërkesë e qëndrueshme, për faktet si në vijim:

Materiali i jelekut taktik — najlon 1000D Cordura ose material ekuivalent — është material teknik me shtresim (coated fabric) dhe me trajtim për rezistencë ndaj ujit, i dizajnuar për përdorim në kushte të rënda. Ky material nuk është një pëlhurë tekstile e zakonshme e endur pa trajtim, por një strukturë e kombinuar që shpesh ka veshje (coating) ose laminime për rritje të qëndrueshmërisë mekanike dhe mbrojtjes nga lagështia.

ISO 13934 (tërheqje) dhe ISO 13937 (çarja) janë standarde të fokusuara kryesisht për pëlhura tekstile të zakonshme të endura ose të thurura, pa shtresa të veçanta mbrojtëse ose veshje të rëndësishme. Këto metoda nuk marrin plotësisht parasysh sjelljen mekanike të materialeve të veshura (coated fabrics) ose të laminuara, dhe nuk japin rezultatet më

përfaqësuese për tekstile teknike si Cordura e trajtuar. Ky konstatim i yni mund të vërtetohet shumë lehtë nëse kërkohet edhe në internet (shih foton që po e bashkangjesim më poshtë):

## Textiles — Tensile properties of fabrics —

### Part 1:

### Determination of maximum force and elongation at maximum force using the strip method

#### 1 Scope

This part of ISO 13934 specifies a procedure to determine the maximum force and elongation at maximum force of textile fabrics using a strip method.

NOTE ISO 13934-2 describes the method known as the grab method. For informative references, see Bibliography.

The method is mainly applicable to woven textile fabrics, including fabrics which exhibit stretch characteristics imparted by the presence of an elastomeric fibre, mechanical, or chemical treatment. It can be applicable to fabrics produced by other techniques. It is not normally applicable to geotextiles, nonwovens, coated fabrics, textile-glass woven fabrics, and fabrics made from carbon fibres or polyolefin tape yarns (see Bibliography).

The method specifies the determination of maximum force of test specimens in equilibrium with the standard atmosphere for testing, and of test specimens in the wet state.

The method is restricted to the use of constant rate of extension (CRE) testing machines.

#### Sqarim për standardet ISO 1421 dhe ISO 4674:

-ISO 1421 është standardi specifik për pëlhura të veshura (coated fabrics) dhe përcakton forcën e tërheqjes duke marrë në konsideratë ndikimin e shtresës mbrojtëse dhe të strukturës së përbërë të materialit. Ky standard siguron që testimi të reflekttojë realisht rezistencën që materiali do të ketë në përdorim praktik në kushte të rënda.

-ISO 4674 përcakton metodën për testimin e rezistencës ndaj grisjes (tear resistance) të pëlhurave të veshura. Për jelekun taktik, rezistenca ndaj grisjes është kritike për sigurinë dhe jetëgjatësinë, sidomos duke qenë se përdorimi përfshin ngarkesa mekanike të larta, tërheqje të papritura dhe kushte agresive.

Si përfundim ju sqarojmë se përdorimi i ISO 1421 dhe ISO 4674 duhet të lejohet, pasi këto standarde janë të destinuara posaçërisht për materiale të veshura dhe teknike si najloni 1000D Cordura, dhe ofrojnë rezultate më të sakta dhe përfaqësuese të performancës së materialit në aplikime taktike dhe ushtarake. Ndërsa ISO 13934 dhe ISO 13937 të kërkuara nga AK, edhe pse janë të vlefshme për tekstile të zakonshme, nuk pasqyrojnë në mënyrë të plotë sjelljen e këtij lloji materiali të specializuar.

Pra kur kemi parasysh të gjitha sqarimet e lartcekura, kërkojmë edhe një herë që të lejohet përdorimi i standardeve të kërkuara më lartë ISO 1421 dhe ISO 4674, duke u larguar standardet ISO 13934 dhe ISO 13937, ose të lejohet përdorimi i të dy standardeve duke u cilësuar si ekuivalente, ashtu siç e ka lejuar autoriteti kontraktues në specifikat e vendosura në dosje të tenderit. Nëse eventualisht kjo kërkesë e jona nuk do të aprovohet, ju sqarojmë se pa dashur që një gjë e tillë të merret si kërcënim ne jemi të detyruar të vazhdojmë me ankimime edhe në instancat tjera më të larta.

#### 3. Tek kërkesat mbi kapacitetin ekonomik dhe financiar është kërkuar *Kërkesa 8 Kapaciteti*

*ekonomik dhe financiar* Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK-së , se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tri viteve ( 2022, 2023, dhe 2024), se bashku në vlerë, prej jo më pak ; 500,000.00 €”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “Evidenca 7 Raportet përkatëse nga një ose me shumë banka mbi kapacitetin ekonomik dhe financiar nga ndonjë banke e licencuar ose Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit ,– kopje Nëse Operatori ekonomik përmbush kërkesën e qarkullimit vetëm me një apo dy vite, do të thotë se OE ka përmbushur kërkesën minimale të përcaktuar në dokumentet e tenderit, kusht i domosdoshëm dhe i detyrueshëm për t'u kualifikuar.”.

Kërkojmë që të ndryshohet kërkesa e lartcekur sipas Interpretimit nr.24 të KRPP-së, të lëshuar me dt.29.03.2023.

Pra kërkojmë nga ju që të na sqaroni se a lejohen të prezantohen deklaratat tatimore vjetore edhe nga **vendi i themelimit të OE**

**4.** Tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, është kërkuar “Kërkesa 9 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar realizuar (v.j. jo në realizim e sipër) me sukses kontrata të natyrës së njëjte apo të ngjashme gjatë 3 (tri) viteve të fundit (nga data e publikimit të njoftimit për kontratë ), jo më pak se; 500,000.00 €”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “Evidenca 9. OE duhet të ofrojë dëshmi a). Listën e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit ( nga data e publikimit të këtij njoftimit për kontratë) e nënshkruar dhe vulosur nga OE. b). Referencat ose fletët pranimit pranimit teknike në kopje të nënshkruar dhe vulosur nga Autoritet për përkatës të cilat duhet të tregojnë, numrin e prokurimit ose kontratës, vlerën e kontratës , datën e nënshkrimit të kontratës, dhe vendin e realizimit. Vërejtje Asnjë kontratë nuk do të llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca pozitive ose raportet e flete pranimeve të furnizimeve nëse është bërë për një autoritet publik apo privat në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi duhet të dorëzohen fletëpranimit ose referencat (në referenca të jete e cekur vlera) të lëshuara nga autoriteti i tillë. Për referenca nga institucionet private, duhet të dëshmohet qarkullimi bankar origjinal nga banka për vlerën referencës së prezantuar. Nëse Operatori ekonomik përmbush kërkesën vetëm me një apo dy vite, do të thotë se OE ka përmbushur kërkesën minimale të përcaktuar në dokumentet e tenderit, kusht i domosdoshëm dhe i detyrueshëm për t'u kualifikuar”.

Në lidhje me kërkesën e lartcekur, kërkojmë nga ana e AK-së që të bëjë ndryshimin e saj duke e zvogëluar vlerën e kontratave të përfunduara në tri vitet e fundit, pasi që kontrata të tilla ose të ngjashme kanë nënshkruar vetëm disa kompani të caktuara, prandaj në këtë rast po favorizohen kompani të caktuara, ndërsa po diskriminohen kompanitë të cilat posedojnë kontrata të përfunduara në vlera në të vogla se sa vlera e kërkuar nga ana juaj.

Andaj me qëllim të hapjes së konkurrencës dhe me qëllim që të ju mundohet ofertimi edhe kompanive të reja, kërkojmë që të zvogëlohet vlera e kontratave të kërkuara në minimum 200,000.00 euro.

**5.** Te kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar: “Kërkesa 10 OE duhet se bashku me ofertat të dorëzojë nga një mostër për të gjithë artikujt pjesë të këtij tenderi. Mostrat duhet të dorëzohen në formë fizike para afatit të fundit për dorëzim të tenderëve”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “Evidenca 10. Mostrat e artikujve të kërkuar duhet të dorëzohen të paketuara Vërejtje Mospërputhja e mostrave sipas kërkesave të dhëna në DT Aneksi 1, do të ketë për pasojë eliminimin e ofertës tuaj”.

Ne kërkojmë që të largohet kërkesa që mostrat të dorëzohen nga të gjitha kompanitë që ofertojnë dhe mostrat të i kërkojnë vetëm kompanisë e cila i plotëson të gjitha kërkesat tjera.

Kjo kërkesë e jona mendojmë që është e nevojshme dhe duhet të aprovet sepse kompanitë të cilat po dorëzojnë oferta po ju krijohen shpenzime të panevojshme dhe në fund nuk po shpallen fituese.

Kjo sjell kosto të panevojshme për pjesëmarrësit dhe dekurajon konkurrencën, sepse përfshirja në tender bëhet më pak atraktive nga pikëpamja financiare.

Kërkojmë që kërkesa për dorëzim të mostrave të modifikohet në mënyrë që mostrat të kërkojnë vetëm nga ofertuesi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

Kërkesa jonë është e bazuar në nenin Neni 37-Mostrat e tenderëve, të RRPP-së 01/2022, sepse në pikën 37.1 shënohet që: *Dokumentet e tenderit në përgjithësi duhet të shmangin kërkesën për paraqitjen e mostrave, pasi kjo kërkesë dekurajon konkurrencën dhe rrit çmimet e ofertës. Përndryshe, tenderuesve duhet t'u kërkojë të konfirmojnë që produkti i tyre plotëson specifikimet e kërkuara dhe në mbështetje të bashkëngjitni certifikatat e duhura të testimit nga laboratorë të njohur testimi.*

Pra ne nuk po kërkojmë të largohen në tërësi mostrat, mirëpo po kërkojmë që mostrat të kërkojnë vetëm nga kompania e cila i plotëson të gjitha kërkesat e DT dhe është ofertuese me çmim më të lirë

Pasi të sqarohen pretendimet tona, kërkojmë nga ana e OSHP-së që të detyroj, AK-së që të shtyhet data e hapjes edhe për minimum 30 ditë me qëllim që të bëhet prodhimi i specifikave të jelekut sipas ndryshimeve të kërkesave.

Ne me dt.14.08.2025 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që nuk është dhënë asnjë arsyetim konkret për një refuzim të tillë.

Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim ka dhënë arsyetimin si në vijim:

Pas shqyrtimit të pretendimeve në lidhje me dispozitat e shkelura të LPP-së nga Autoriteti Kontraktues, konstatojmë se kërkesa për rishqyrtim është e pabazuar dhe të gjitha pyetjet dhe kërkesat për sqarime në kërkesë për rishqyrtim nga Operatorët Ekonomik në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit **Ritender – “Furnizim me jelek taktik - SUFSK 1001 për nevojat e FSK-së”** do të ngarkojmë në platformën E-Prokurimi brenda afateve të parapara me ligj duke bërë korrigjimin e dosjes së tenderit.

AK-ja e ka cekur se kërkesa për rishqyrtim është e pa bazuar dhe të gjitha pyetjet dhe kërkesat për sqarime në kërkesë për rishqyrtim, do të ngarkojnë në platformën E-Prokurimi brenda afateve të parapara me ligj duke bërë korrigjimin e dosjes së tenderit.

Ky arsyetim i autoritetit kontraktues është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm për faktin se njëjta është dashur të jep përgjigjet e saj në pretendimet tona ankimore, në këtë vendim dhe jo të publikoj sqarimet në platformë, pasi që neve po na refuzohet kërkesa për rishqyrtim, ndërsa në momentin që refuzohet kërkesa atëherë kuptohet qartë se pretendimet tona ankimore nuk janë marr parasysh.

Sa i përket sqarimeve të cilat AK-ja i ka publikuar me dt.15.08.2025, ju sqarojmë se e njëjta përsëri edhe me sqarime shtesë nuk është e qartë se a e ka lejuar tolerancën prej +2% për të gjithë xhepat e jelekut. E njëjta e ka komplikuar edhe më shumë në përgjigjjen e saj specifikën teknike në lidhje me xhepat, pasi që në përgjigjjen e saj diku e cek se për xhepat e jashtëm aplikohet tolerancë e njëtrajtshme +-2.5mm, ndërsa në një vend tjetër e cek që asnjë dimension i xhepit nuk lejohet të tejkaloj +-5mm.

Prandaj në këtë rast sqarimi të cilin e ka vendosur AK-ja në e prokurim, nuk është i qartë, andaj kërkojmë nga OSHP-ja që të detyroj të njëjtën që sipas pretendimit tonë ankimor të lejoj tolerancën prej  $\pm 2\text{cm}$  për të gjithë xhepat e jashtëm, me qëllim që produkti të dorëzohet në përputhje të plotë me standardet e përmasave të NATO-s dhe ushtrisë amerikane.

Sa i përket pretendimit tonë ankimor në lidhje me ndryshimin e ISO standardeve, AK-ja në sqarimet e saj të dt.15.08.2025 ka dhënë përgjigje të paqartë sepse fillimisht e cek që nuk pranohet standardet tona si zëvendësim, ndërsa pastaj e cek se nuk ndalohet ofertimi me material të veshur, për aq kohë sa përmbushen kërkesat e DT. Pastaj ceket se në rastet kur ofertohe me coated fabrics, testimet shtesë do të konsiderohen ekuivalente për vlerësim teknik por nuk zëvendësojnë testet bazë të kërkuara në DT.

Këto sqarime të AK-ja janë të paqëndrueshme, për faktin se ne e kemi sqaruar qartë se pas analizës së përgjigjes së AK-së kemi ardh në përfundim që kërkesa jonë që të lejohen këto standarde të testimit ISO 1421 dhe ISO 4674, në vend të ISO 13934 dhe ISO 13937, është kërkesë e qëndrueshme, për faktet si në vijim:

Materiali i jelekut taktik — najlon 1000D Cordura ose material ekuivalent — është material teknik me shtresim (coated fabric) dhe me trajtim për rezistencë ndaj ujit, i dizajnuar për përdorim në kushte të rënda. Ky material nuk është një pëlhurë tekstile e zakonshme e endur pa trajtim, por një strukturë e kombinuar që shpesh ka veshje (coating) ose laminime për rritje të qëndrueshmërisë mekanike dhe mbrojtjes nga lagështia.

ISO 13934 (tërheqje) dhe ISO 13937 (çarja) janë standarde të fokusuara kryesisht për pëlhura tekstile të zakonshme të endura ose të thurura, pa shtresa të veçanta mbrojtëse ose veshje të rëndësishme. Këto metoda nuk marrin plotësisht parasysh sjelljen mekanike të materialeve të veshura (coated fabrics) ose të laminuara, dhe nuk japin rezultatet më përfaqësuese për tekstile teknike si Cordura e trajtuar. Ky konstatim i yni mund të vërtetohet shumë lehtë nëse kërkohet edhe në internet (shih foton që e kemi bashkangjitur më lartë në ankesë). Si përfundim ju sqarojmë se përdorimi i ISO 1421 dhe ISO 4674 duhet të lejohet, pasi këto standarde janë të destinuara posaçërisht për materiale të veshura dhe teknike si najloni 1000D Cordura, dhe ofrojnë rezultate më të sakta dhe përfaqësuese të performancës së materialit në aplikime taktike dhe ushtarake. Ndërsa ISO 13934 dhe ISO 13937 të kërkuara nga AK, edhe pse janë të vlefshme për tekstile të zakonshme, nuk pasqyrojnë në mënyrë të plotë sjelljen e këtij lloji materiali të specializuar.

**Në lidhje me këtë çështje kërkojmë që të caktohet një ekspert teknik i tekstilit, me qëllim që të analizoj dhe sqaroj në detaje pretendimet tona ankimore.**

Sa i përket pretendimit tonë ankimor në lidhje me ndryshimin e kërkesës për qarkullimin vjetor, ku kemi kërkuar që të bëhet ndryshimi i kërkesës duke e specifikuar që të prezantohen deklaratat tatimore nga vendi i themelimit, konform interpretimit të KRPP-së nr.24, AK-ja në sqarimin e saj e ka cekur si në vijim:

**Përgjigje 3.**

Kërkesa mbetet e pandryshuar. Operatorit Ekonomik i kërkohet qarkullim vjetor kumulativ për vitet 2022, 2023 dhe 2024 në vlerë jo më pak se 500,000.00 €. Kjo vlerë mund të arrihet edhe vetëm me një (1) ose dy (2) vite brenda intervalit të lartcekur.

Dokumentet e pranueshme të dëshmisë (njëra ose të dyja, sipas rastit):

- Raporte bankare nga banka të licencuara; dhe/ose
- Deklarata Tatimore Vjetore të dorëzuara në ATK ose në administratën tatimore të vendit të themelimit të OE (për vitet përkatëse).

Kjo në përputhje me Interpretimin nr. 24 të KRPP-së, datë 29.03.2023.

Forma/validiteti i dokumenteve. Dokumentet duhet të jenë të lëshuara nga organet kompetente; nëse janë në gjuhë të huaj, të shoqërohen me përkthim zyrtar. Nëse shumat janë në valutë tjetër, të paraqitet konvertimi në € me metodologji të qartë (p.sh. kurs mesatar vjetor).

Verifikimi. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të kërkojë sqarime shtesë dhe të verifikojë autenticitetin e dokumenteve pranë institucioneve përkatëse.

Bazuar në ato që u than më lartë nuk ka bazë për ndryshim të tekstit të DT-së në këtë pikë.

Autoriteti kontraktues në këtë rast ka vepruar në kundërshtim me interpretimin nr.24 të KRPP-së të dt.29.03.2025, pasi që nuk e ka ndryshuar kërkesën e dosjes së tenderit. E njëjta e ka cekur se lejohet të prezantohen deklaratat tatimore të dorëzuara në ATK ose në administratën tatimore të vendit të themelimit të OE dhe nuk ka bazë për ndryshim të kërkesës së DT-së. Arsyeimi i AK-së është i paqëndrueshëm dhe shumë kundërthënës sepse në njërin anë e cek se deklaratat tatimore të dorëzuara në ATK ose në administratën tatimore të vendit të themelimit të OE janë në përputhje me interpretimin e KRPP-së, ndërsa në anën tjetër nuk e ndryshon kërkesën e dosjes së tenderit.

Sa për sqarim kërkesa e dosjes së tenderit është ende në dosje të tenderit e specifikuar si në vijim:

*Evidenca 7 Raportet përkatëse nga një ose me shumë banka mbi kapacitetin ekonomik dhe financiar nga ndonjë banke e licencuar ose **Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit**, – kopje Nëse Operatori ekonomik përmbush kërkesën e qarkullimit vetëm me një apo dy vite, do të thotë se OE ka përmbushur kërkesën minimale të përcaktuar në dokumentet e tenderit, kusht i domosdoshëm dhe i detyrueshëm për t'u kualifikuar.*

Ndërsa në lidhje me pretendimet tjera ankimore AK-ja ka publikuar sqarime krejtësisht të pa bazuara dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merren si të mirëqena.

Ne kërkojmë nga OSHP-ja që ti analizoj në detaje pretendimet tona ankimore, pasi që në këtë mënyrë po diskriminohemi ne si kompani e interesuar për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit dhe po favorizohen OE të caktuar.

Autoriteti kontraktues është duke e treguar haptas diskriminimin që po na bën neve si kompani, pasi që në vendim për kërkesë për rishqyrtim nuk ka dhënë përgjigje fare por ka publikuar sqarime pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, me qëllimin e vetëm që të na humb afatin për parashtrim të ankesës në OSHP.

Prandaj kërkojmë që pretendimet tona ankimore të trajtohen nga ekspert të fushës, sepse konstatimet e AK-së janë të paqëndrueshme dhe jo të bazuara në hulumtime të sakta.

Këto kërkesa bien ndesh plotësisht me nenin 7 të LPP-së përkatësisht paragrafët 1, 2, 3 dhe 6. Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.

Me këto kërkesa, jo që nuk mund të ketë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik por do të ketë diskriminim të hapur dhe përcaktim të fituesit qysh në start të këtij aktiviteti të prokurimit, pa konkurrencë të hapur.

Paragrafi 6 i dispozitës së nenit 7 parasheh qartë : *Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e*

prokurimit”.

Me këto kërkesa nuk mundësohet pjesëmarrje e gjerë e operatorëve ekonomik, por në këtë mënyrë është kufizuar tej mase konkurrenca dhe këto kërkesa janë drejtpërdrejtë jo në harmoni me çmimin dhe lëndën e prokurimit sepse kur kufizohet konkurrenca me kërkesa të pa nevojshme atëherë edhe çmimi ofertues i operatorëve ekonomik të favorizuar automatikisht është shumë më i lartë sepse nuk kanë konkurrencë dhe faktikisht determinohet çmimi nga ana e autoritetit kontraktues në bazë të kërkesave të dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe kundërshtimet tona që u cekën më lartë rezulton se ju si autoritet kontraktues nuk e keni përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me nenin 27 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk e keni pasur parasysh as nenin 17.7 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik ku shkruan qartë që *“Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë që nuk: Kufizon konkurrencën në mesin e OE, ose Diskriminon kundër ose vepron në favor të një ose më shumë OE-ve”*.

Duke u bazuar në të gjitha ato kërkesa diskriminuese-favorizuese dhe në ato dëshmi të kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.*

Kërkesat e lartcekura bien në kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1, 3, 4 dhe 6 të LPP-së, sepse në këta paragraf parashihet qartë që operatorët ekonomik nuk mund të diskriminohen në asnjë mënyrë dhe në asnjë variant. Prandaj kërkesat të cilat i kontestuar më lartë duhet larguar/ndryshuar për të pasur një aktivitet të prokurimit normal dhe për të mos u diskriminuar/favorizuar kompanitë e caktuara.

Kërkesat që u kundërshtuan më lartë, janë shumë favorizuese/diskriminuese dhe njëkohësisht ua mbyllin dyert e ofertimit shumë kompanive me eksperiencë në këtë fushë dhe gjithashtu këto kërkesa bijnë në kundërshtim edhe me nenin 25.4 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik, sepse aty shkruan qartë se *“Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do të kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike”*.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

#### VENDIM

**APROVOHET**, si e bazuar ankesa e OE **“Smart X Industries” SH.P.K.**

**DETYROHET AK** të bëj ndryshimin e kërkesave, që u cekën më lartë nga ana jonë dhe pastaj të veproj konform nenit 53.7 të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Dëmet materiale akoma nuk janë llogaritur sepse jemi në fazën e njoftimit për kontratë dhe fazën para ofertuese.

## **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*